4	Boller Elektrik	cope	2	44,200.0	88,400.0
5	Aspirator Banjo	cope	2	9,100.0	18,200.0
6	Puseta Plastike	cope	2	16,084.3	32,168.7
7	Materiale Hidraulike	cope	2	320,368.3	640,736.7
8	Materiale Elektrike	cope	3	144,568.1	433,704.2
9	Puseta	cope	7	8,200.0	57,400.0
10	Panele fibridruri	cope	9	70,000.0	613,200.0
11	Kolektor	cope	10	20,300.0	203,000.0
12	Vida te permasa te ndryshme	kuti	20	575.0	11,500.0
13	Tuboo Betoni F300	ml	32	537.5	17,200.0
14	Kolle	Kg	35	1,750.0	61,250.0
15	Tubo	Kg	57	301.9	17,208.4
16	Stuko Mbushese	cope	75	1,945.3	145,900.0
17	Tuba plastik me gjithe bashkues	m	77	2,068.8	159,296.1
18	Tubo Gome Izolues	ml	80	107.0	8,560.0
19	Stoko	Kg	150	195.0	29,250.0
20	Felizol	cope	403	450.0	181,350.0
21	Tubo Alumini termo.	ml	515	87.6	45,120.0
22	Tubo Plastik kg	Kg	954	389.2	371,310.0
23	Pllaka A13	m2	1,060	189.7	201,082.0
24	Konstruksion Metalik	Kg	1,200	130.0	156,000.0
25	Hekur ndertimi	Kg	1,420	67.6	96,014.1



Korsel Shpk
Shenimet e pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019

26	cimento	Kg	3,800	8.4	31,853.0
27	Tulla 9x14x33	cope	15,262	20.8	317,960.0
Totali					3,977,046.5

Magazina/ Materiale te para

NR	Pershkrimi	Njesia	Gjendje	Kosto	Vlefta
1	fshesa per makineri	cope	1.00	17,100.00	17,100
2	Elektroshare	cope	1.00	14,000.00	14,000
3	Disk 292-160	cope	1.00	21,250.00	21,250
4	Pomp Hawk	cope	1.00	61,000.00	61,000
5	Ste me trapan 10.8v	cope	1.00	19,000.00	19,000
6	Karocë Dore	cope	2.00	2,246.58	4,493
7	Goma viking	cope	2.00	45,000.00	90,000
8	Kostum shiu	cope	3.00	553.00	1,659
9	Gjenerator	cope	3.00	2,850.00	8,550
10	Materiale Hidrosanitare	cope	3.00	455,104.23	1,365,313
11	Granil	m3	5.00	800.00	4,000
12	Dep cc 1000	cope	6.00	6,000.00	36,000
13	Polisterol	m3	6.00	4,937.50	29,625
14	Bateri 80 AM	cope	6.00	6,944.45	41,667
15	Filter Ajri	cope	8.00	687.50	5,500
16	Arkivol	cope	12.00	4,917.02	59,004
17	Goma Mishelin	cope	16.00	30,652.08	490,433
18	Furca pastrimi	cope	18.00	1,427.59	25,697
19	Gure Prese Inoxi	cope	20.00	120.00	2,400
20	Kazem	cope	20.00	696.19	13,924
21	Doreza HG NG01	cope	24.00	60.77	1,459
22	Kova Metalike	cope	30.00	273.33	8,200



Korsel Shpk
Shenimet e pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019

23	Doreza Lekure	cope	35.00	95.18	3,331
24	Doreza Plastike	cope	36.00	83.33	3,000
25	Koperton Gomerdare	cope	37.00	588.85	21,787
26	Pelerine Shiu	cope	40.00	348.77	13,951
27	Pluhur Guri	cope	45.00	1,570.86	70,688
28	Gurre trohoje	cope	50.00	95.00	4,750
29	Bishta Veglash	cope	52.00	55.92	2,908
30	Llampa Ekonomike	cope	54.00	125.00	6,750
31	Lopata	cope	60.00	424.00	25,440
32	Kabell Fror 5x4	cope	60.00	106.76	6,406
33	Goma	cope	63.00	8,236.08	518,873
34	Goma General	cope	78.00	5,587.29	435,808
35	Kosha mbeturinash	cope	95.00	334.15	31,744
36	Qese Plastmasi	cope	100.00	37.00	3,700
37	Antifriz	Liter	100.00	150.00	15,000
38	Koka fshese	cope	120.00	3,705.80	444,696
39	Cizme	cope	120.00	180.00	21,600
40	Llampa Led	cope	120.00	110.00	13,200
41	Llamarine	Kg	123.00	75.00	9,225
42	Graso	Kg	170.00	180.84	30,744
43	Tel Xingato	Kg	202.00	108.00	21,816
44	Bishta fshese	cope	222.00	163.36	36,265
45	Goma Kazani	cope	369.00	600.00	221,400
46	Polyethilen	Kg	400.00	150.00	60,000
47	Cizme pvc	cope	434.00	314.68	136,570
48	Profile	Kg	454.00	100.00	45,400
49	kavo saldimi	cope	520.00	55.77	29,000

Korsel Shpk
Shenimet e pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019

50	Katrana cl2	m2	600.00	177.32	106,393
51	Boje plastike	Kg	675.00	186.54	125,917
52	Acid	Liter	775.00	165.53	128,288
53	Fshesa	cope	898.00	322.43	289,546
54	Thas	Kg	1,070.00	213.35	228,290
55	Lubrifikant	Liter	1,469.00	199.64	293,278
56	Plegma tell	Kg	2,227.00	84.44	188,048
57	Alkool per frenat	Kg	3,795.00	153.42	582,222
58	Betaine	Kg	6,210.00	108.86	676,000
59	Gelqere Pluhur	Kg	6,785.00	19.27	130,715
60	Alkool Etilik L70N	Kg	8,250.00	150.93	1,245,200
61	Tapa per shishe vere	cope	12,000.00	36.22	434,640
62	Shishe	cope	14,210.00	41.31	587,015
63	Peshk rasat	cope	35,000.00	12.00	420,000
64	Kripe	Kg	47,140.00	4.50	212,130
66	Gasoll	Liter	165,454.01	134.69	22,285,616
Totali					32,487,622.5

Magazina/ Mallra

NR	Pershkrimi	Njesia	Gjendje	Kosto	Vlefata
	Karton	Kg	144,320	4.00	577,280
Totali					577,280.0

TOTALI 37,041,949

Administratori

MAKSIM FEJZULLA

 ANDER TINA DASTRI
 Index
 KORSSEL
 Maksim Fejzulla
 TORÇE ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE KORÇE

NR. 2090 Rep.

NR. 1365 Kol.



KONTRATE ENFITEOZE

Ne Korçe, sot me date 09 te muajit prill te vitit 2017 (dymijee shtatembëdhjetë), u paraqiten para meje noterit D. Loda, palet kontraktuese si me poshte vijon:

Bashkise Korçe, perfaqesuar nga Kryetari Z. Sotiraq FILO, qe me poshte do te quhet "ENFITEOZEDHENESI";

dhe

Shoqerise "Korsel" shpk, me seli ne Korçë, me NIPT nr.J64104124G, perfaqesuar nga Z.Maksim Fejzulla, Administrator i shoqerise, qe me poshte do te quhet "ENFITEOZEMARRESI".

Mbeshtetur ne nenet 784-800 te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise, ne VKM nr.54 datë 05.02.2014 "Per percaktimin e kriterëve , të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar, Udhezimit nr. 6756 date 03.09.2015 "Per zbatimin e VKM nr.54 datë 05.02.2014 "Per percaktimin e kriterëve , të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", Vendimit te Keshillit te Bashkise Korçe nr.109, date 21.10.2016 "Per fillimin e procedurave të konkursit për dhënie me enfiteoze te siperfaqes prej 12 000 m² te ndodhur në zonën kadastrale 8564 , transferuar në pronësi te "Korça 2008" sh.a" hartojne kete kontrate, me kushtet si me poshte :


NENI 1 OBJEKTI I KONTRATES

1.1 Objekti i kesaj kontrate, eshte dhënie me enfiteozë e siperfaqes prej 12 000 m2 te ndodhur ne Bulevardin "Midhi Kostani" Korce, sipas genplanit bashkelidhur.

NENI 2 QELLIMI I PERDORIMIT DHE INVESTIMI

2.1 Prona e dhene me enfiteoze do te perdoret:

- Enfiteozemarresi ka te drejte dhe detyrime te kryeje investime ndërtimin e Terminalit të Autobuzave në qytetin e Korçës te paraqitur ne planbiznes, perfshire ndertime me karakter te perhershëm, gjithnje ne funksion te arrities se qellimit te percaktuar ne nenin 2.1 te kesaj kontrate.





Qellimi i perdorimit te prones se marre me enfiteoze dhe investimet te kryhen sipas projektit te paraqitur dhe nuk mund te ndryshohen pa miratimin me shkrim te enfiteozedhenesit.

**NENI 3
KOHEZGJATJA**



- 3.1 Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë 20 vjecare me të drejtë rilidhje.
- 3.2 Kjo kontratë hyn në fuqi që prej datës së nënshkrimit të saj.

**NENI 4
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ENFITEOZEDHENESIT**

- 4.1 Enfiteozedhenesi nepermjet administrates se shoqerise “Korça 2008” sh.a. Korçe, si njesi ne pronësi te objekteve duhet t’i dorëzojë objektin enfiteozemarresit, brenda nje muaji pas nenshkrimit nga palet, te lire per t’u shfrytezuar sipas përcaktimeve te kësaj kontrate .
- 4.2 Enfiteozedhenesi ka te drejte te kontrolloje ne çdo kohe respektimin e kushteve te kesaj kontrate, perfshire dhe realizimin e projektit te investimit te parashikuar ne te gjithë treguesit dhe punesimin.
- 4.3 Enfiteozedhenesi eshte i detyruar te marre ne dorezim sendin ne castin e mbarimit te afatit apo te zgjidhjes se kontrates.
- 4.4 Enfiteozedhenesi ka te drejten te pretendoje mbajtjen e te gjitha shtesave apo permiresimeve qe i jane bere sendit, nqs enfiteozemarresi nuk ka shlyer te gjitha detyrimet, deri ne momentin qe do te likuidohen te gjitha detyrimet kundrejt tij.
- 4.5 Enfiteozedhenesi ka te drejte te kërkojë zgjidhjen e kontratës dhe mbarimin e enfiteozes kur enfiteozemarresi nuk ka shyer detyrimin perkates per dy periudha rresht, demton ose nuk miremban e permireson pronen e nuk permbush ne menyre te dukshme detyrimet qe rrjedhin nga kontrata.
- 4.6 Enfiteozedhenesi eshte i detyruar te shlyeje vleren e mbetur te permiresimeve qe i jane bere prones sipas plan-biznesit te paraqitur, te vleresuara keto ne momentin e dorezimit te sendit.
- 4.7 Enfiteozedhenesi ne momentin e zgjidhjes se kontrates ka te drejte te mbaje permiresimet e bera nga enfiteozemarresi, sipas plan-biznesit te paraqitur deri ne shlyerjen e detyrimeve te ketij te fundit.

**NENI 5
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ENFITEOZEMARRRESIT**

- 5.1 Enfiteozemarresi duhet ta perdore dhe ta gezoje sendin njelloj sikur te ishte pronar i tij me përjashtim të kufizimeve të parashikuara në këtë kontratë.
- 5.2 Enfiteozemarresi detyrohet të mos i ndryshojë destinacionin objektit.
- 5.3 Enfiteozemarresi detyrohet te paguaje për llogari të shoqërisë “ Korça 2008” sha detyrimin mujor prej 240 000 lekë në muaj (dyqind e dyzet mijë lekë) brenda datës 5 të muajit pasardhës. Per çdo ditë vonese do te paguaje nje kamate ditore prej 0.1% te vleres se shperblimit mujor.
- 5.4 Enfiteozemarresi ka te drejte ta perdore sendin duke perfituruar te gjitha te ardhurat natyrore, civile dhe ato te nentokes se sendit.



- 
- 5.5 Enfiteozemarresi ka detyrimin të kryejë të gjitha riparimet e zakonshme të sendit, për ruajtjen dhe mirembajtjen e tij dhe duhet ta kthejë sendin në të njëjten gjendje që e ka marrë duke llogaritur shkallen e amortizimit natyror të tij dhe përmirësimet që palet do të parashikojnë.
- 5.6 Enfiteozemarresi nuk mund ta japë me nënënfiteoze tek të tretët sendin, objekt i kësaj kontrate.
- 5.7 Në ngarkim të enfiteozemarresit janë të gjitha tatimet dhe taksat që rendojnë mbi pronën e dhënë me enfiteoze.
- 5.8 Enfiteozemarresi ka të drejtën e marrjes të të gjitha shtesave dhe përmirësimeve që i ka bërë sendit nëqë kjo nuk demton pronën në mënyrë që ai të kthehet pronarit në gjendjen e marrë në dorezim. Në rast të kundërt, ai ka të drejtën të kërkojë vleftën e tyre të llogaritur në kohën kur bëhet kthimi i sendit.
- 5.9 Enfiteozemari detyrohet të kryejë pagesën e garancisë së kontratës në masën 720 000 lekë (shtatëqind e njëzet mijë lekë).

NENI 6 PAGESA E QIRASE


- 6.1 Enfiteozemarresi detyrohet të paguajë Enfiteozedhënesit për llogari të shoqërisë "Korça 2008" sh.a detyrimin mujor në vlerën prej 240 000 lekë në muaj (dyqind e dyzet mijë lekë),
- 6.2 Pagesa do të bëhet deri në datën 5 të çdo fillim muaji, për muajin paraardhës pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogarinë nr. _____ të shoqërisë "Korça 2008" sh.a. Korçe.
- 6.3 Pagesa fillon nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate.

NENI 7 ZGJIDHJA E KONTATËS

- 7.1 Kontrata zgjidhet në përfundim të afatit të përcaktuar më sipër.
- 7.2 Kontrata mund të zgjidhet para afatit:
- a. Me marrëveshje midis paleve
 - b. Kur kjo kërkohej nga enfiteozemarresi me kusht që të njoftohet enfiteozedhënesi jo më pak se 30 ditë para.
 - c. Kur kjo kërkohej nga enfiteozedhënesi dhe jemi në rastet kur
 - Enfiteozemarresi e demton pasurinën e marrë,
 - Nuk e miremban atë,
 - Nuk i bën përmirësimet që janë parashikuar në kontratë ose
 - Kur nuk paguan shpërblimin e enfiteozes për dy periudha të njëpasnjëshme

NENI 8 PERGJEGJESITË E PALEVE

- 8.1 Palet përgjigjen për mosrespektimin e kushteve të kësaj kontrate.
- 8.2 Palet janë të detyruara që në fillim të çdo viti të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta për realizimin e detyrimeve në derdhjet e pagesës, në nivelin e punësimit, në nivelin e investimit dhe në kamat ose gjobat (në rastet kur ka të tilla) të vendosura sipas neneve të kësaj kontrate.



Imp/Exp



REPUBLIKA E ALBANIË
MINISTRI E TËRHEQJESIA DHE FINANCËVE
KORÇË

8.3 Per qellimet e kesaj kontrate "Force Madhore" do te kuptohet nje ngjarje qe eshte jashte kontrollit te paleve si termetet, lufta, permbytjet etj. Ne keto raste palet jane te detyruara te njoftojne njera-tjetren.

8.4 Enfiteozmarresi perjashtohet nga detyrimet e pageses per kohen e vazhdimit te Forces Madhore gjate se ciles nuk kryen aktivitet per kete shkak. Kjo periudhe do te percaktohet me marrveshje midis paleve.

NENI 9 DISPOZITA TË FUNDIT

9.1 Për gjithçka qe nuk eshte shprehur posaçërisht ne këtë kontratë, i referohet dispozitave te legjislacionit civil në fuqi.

9.2 Mosmarrveshjet që lindin midis palëve gjatë zbatimit e kësaj kontrate do te zgjidhen me mirëkuptim dhe ne rast se kjo është e pamundur kompetente për zgjidhjen e konfliktit është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë.

9.3 Kontrata 30 (tridhjete) dite pas nenshkrimit te saj duhet te rregjistrohet ne regjistrin e pasurive te paluajtshme Korçë.

9.4 Kjo kontratë është hartuar ne gjashte kopje origjinale.


Kjo kontrate enfiteoze, ju lexua paleve, te cilet e kuptuan dhe e pranuan ate, e nenshkruan para meje me vullnetin e tyre te plote e te lire, kurse une noterja Denada Kodiq ne baze te nenit 784-800 te Kodit Civil e vertetoj sipas ligjit rregullisht.

Enfiteozedhenesi

Bashkia Korce

Kryetari

Sotiraq FILO



Enfiteozemaresi

Shoqeria "Korsel" sh.p.k

Administratori

Maksim Fejzulla

MAKSIM FEJZULLA



Notere

Denada Kodiq



[Signature]





MAKSYM PASTI
Imp. E. Gjermani
KORSEI
Maksim
Fejzulla
REPUBLIKË E SHQIPËRIE
ALBANIA

SUPERFAQJA 12 000m²
KUFIRI I PRONES



PLAN VENDOSJE

OBJEKTI: TERMINAZI
SHKALLA 1:7000

8564

PER D.P.K.ZH.T
ING. E. GJERMANI
URB. ZH. LUBONJA

**REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE KORÇE**

Nr. 603 rep

Nr. 565 kol



KONTRATE QERAJE

Ne Korçe, Sot më date **02.02.2017** (dy mijë e shtatëmbëdhjetë), përpara meje Noter Bledar Edmond Zake, anëtar i Dhomës së Noterisë Korçë me adresë në: Korçë, ne Rrugen "28 Nentori", Përballë Deges se Tatim Taksave u paraqiten personalisht palet :

PALET :

1. **Sulejman Qemal Pasho datelindje 24.02.1962 karte identiteti me nr 027570488 nr personal G20224072P** është madhor i afte për të kryer veprime juridike i pa njohur prej meje personalisht për identitetin e të cilit u njoha me dokumentin përkatës këtu e me poshtë do të quhet "**Qiradhens**" nga ana tjetër.
1. **Shoqëria " Korsel " shpk perfaqesuar nga Maksim Fejzulla datelindje 20.02.1955, karte identiteti me nr 025798979 nr personal F50220316F me Nipt J64104124G** është madhor i afte për të kryer veprime juridike i panjohur prej meje personalisht për identitetin e të cilit u njoha me ane të dokumentit përkatës këtu e me poshtë do të quhet "**Qiramares**" nga ana tjetër.

BAZA LIGJORE

Kodit Civil i Rrepublikes se Shqiperise Ligji Nr. 7829, date 01.06.1994 "Per Noterine", (i ndryshuar) e legjislacioni i fushes ne fuqi.

DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME

Neni 1

Objekti i kontratës

« Qiradhënësi » deklaron se ka në pronësi të tij një shtëpi banimi të formës tre kate të ndodhur në ndodhur në qytetin e Korçës, në Rr "Shetitore Fan Stilian Noli" pronësi e cila vërtetohet me Lejen e Ndertimit Nr 4/12 date 11.02.2006 të KRRT Korçe.

Qiradhenesi deklaron se katin e dytë të banesës me sipërfaqe 48 m² ja jap me qira qiramarsit Shoqëria " Korsel " shpk për ta përdorur për zyrë dhe qiramaresi nga ana e tij deklaron se është dakort në marrjen me qira të katit të dytë të banesës me sipërfaqe 48 m² të përkrahur me lart për ta përdorur për zyrë .

Neni 2

Afati i kontratës

Afati i kontratës është 5 vjet . Efektet financiare të kësaj kontrate do të fillojnë në ditën e sotme 02.02.2017 dhe në vazhdim 02.02.2022 .

Neni 3

Vlera e qirasë

1. Vlera e qirasë për Njesinë e përmendur më lart është me vlerë 10.000 leke (dhjetë mijë leke) në muaj dhe do të paguhet çdo fillim muaji nga data 1 deri në datë 5 të çdo muaji.

Neni 4

Pagesa dhe regjimi i saj

agesa e qirasë bëhet sipas marrëveshjes të tyre se permendur ne nenin 3 te kesaj kontrate.

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRADHËNËSIT

Neni 5

1. "Qiradhënësi" detyrohet ti dorëzojnë qiramarrësit, menjëherë mbas lidhjes së kësaj kontrate, ambjentin duke e lejuar ate ta perdore per zyre .
2. Qiradhënësi deklaron se ambjenti është në rregull dhe në përputhje me normat Urbanistike për ushtrim aktiviteti.

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRAMARRËSIT

Neni 6

1. Mbas nënshkrimit të kësaj kontrate "Qiramarrësi" merr në dorëzim ambjentin objekt i kesaj kontrate qeraje.
2. Riparimet fillestare dhe ndërhyrjet e vogla të mirmbajtjes janë në ngarkim të qeramarsit , dhe per demet e shkaktuara per faj te tij gjate perdorimit do te pergjigjet qeramarsi .
3. Detyrimet per Energji, Uje jane ne ngarkim te qeramarsit .
4. Qiramarsi eshte e deryruar ta mirembaje ambjentin, te mos e demtoje dhe ne rast demtimi do te pergjigjet per demin e shkaktuar .
5. Qiramarsi nuk ka te drejte ta jape ambjentin me nenqira ne persona te trete .

ZGJIDHJA E KONTRATËS

1. Kontrata zgjidhet me mbarimin e afatit, si dhe me marrëveshje midis palëve duke te lene te hapur mundesine per rilidhje te kontrates .
2. Ne rast te prishjes te kontrates para afatit duhet te njoftohet pala tjetere 2 muaj para.
3. Kontrata mund të zgjidhet edhe përpara mbarimit të saj, vetëm kur janë shkëlur dhe nuk janë respektuar kërkesat e saj nga secila palë.

DISPOZITA TË FUNDIT

Mosmarrëveshjet gjatë zbatimit të kësaj kontrate, zgjidhen me mirëkuptimin e palëve; në të kundërt ato zgjidhen në gjykatën e rrethit gjyqësor Korçe

Kjo kontratë qiraje hartohet në 4 kopje, nje prej të cilave i mban Qiradhënësi dy Qiramarrësi dhe nje qendron ne zyren e noterise .

PALET

QIRADHËNËS

Salomon Poshe
[Signature]

QIRAMARES

[Signature]
[Signature]

NOTER
Bledar Zake

B



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISE
DEGA VENDORË KORÇE

Nr. 442 Rep.

Nr. 351 Kol.
2. 1998

KONTRATE QIRAJE

(PASURI E PALUJTSHME)

Sot me date 10.06.2019 (dhjete qershor dymije e nentembdhjete) para meje NOTERE KLEVA VANGJEL TABAKU prane Zyres ime te Noterise te ndodhur ne Rr.Ismail Qemali Korce u paraqiten personalisht palet e hartimit te kesaj kontrate:

QIRADHENES: 1. Kristaq Karanxha i biri i Zikullit me dtl. 30.06.1978 banues ne Korce identifikuar me karte id. Nr. personal H00630037W

QIRAMARRES: Firma "Korsel " SHPK perfaqesuar nga perfaqesuesi ligjor Maksim Fejzulla I biri I Hysenit me dtl. 20.02.1955 banues ne Korce identifikuar me karte id. Nr. personal F50220316F

Te gjithë madhore dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar ,te panjohur prej meje per identitetin e te cileve u sigurova nga dokumenti perkates te cilet shprehen vullnetin e tyre per te redaktuar kete kontrate qiraje ndertese:

PERSHKRIMI I PRONES

Qiradhenesi ka marre me qira nje pasuri te palujtshme truall me afat pesevjecar, me nr. 7/61 pasurie regjistruar ne volumin 23 faqe 130 ne ZK. 8564 ndodhur ne Korce

Siperfaqja e truallit eshte 1493 m2.

Pronesia vertetohet kartelen e pasurise date 10.06.2019 . Qiradhenesit i eshte dhene e drejta nga pronari I sendit , ta leshoje sendin me nenqira per cdo afat dhe ne cdo moment.

Qiramarresi do te marre me qira te gjithë truallin e siperpermendur me siperfaqe 1493 m2.

AFATI

****TRualli do t'i leshohet me qira per nje afat prej 1 viti dhe ky afat ka filluar me 01.06.2019 dhe perfundon me date 01.06.2020**

CMIMI I QIRASE

***** Qiraja mujore do te jete ne masen 40 000 lek ne muaj, e cila do te paguhet brenda dates 5 te cdo muaji .**

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRADHENESIT

***** Sa me siper qiradhenesi eshte i detyruar t'ia dorezoje sendin ne gjendje normale dhe te kujdeset qe qiramarresi te mos shqetesohet ,nga te meta te sendit.**

***** Ai e siguron qiramarrsin nga pretendimet e te treteve per sendin.**

***** Shpenzimet e nevojshme per mirembajtjen e sendit jane ne ngarkim te qiradhenesit ndersa cdo shpenzim tjeter ,do te jene ne ngarkim te qiramarrsesit.**

*** Ka detyrimin te paguaje detyrimet ndaj shtetit si tatimi mbi qirane , ne burim si dhe taksat vendore te truallit.

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRAMARRESIT

*** Qiramarresi eshte i detyruar ta mirembaje sendin.

***Shpenzimet e nevojshme do te perballohen nga qiradhenesi

***Te paguaje qirane rregullisht.

***Eshte i detyruar te paguaje te gjitha detyrimet ndaj te treteve qe jane KESH dhe Ujesjellesi ,perndryshe eshte i detyruar te paguaje demshperblim pervec debive qe mund te jene krijuar me te tretet dhe kamat vonesat.

**Qiramarresi lejohet ne cdo moment ta jape me nenqira ,sendin e palujtshem, sipas afatit te kesaj kontrate dhe kete te drejta ia ka dhene pronari i sendit.

**Ne rast rinovimi, qiramarresi do te jete i preferuar ne lidhjen e kontrates se re .

ZGJIDHJA E KONTRATES

**Kontrata do te zgjidhet me mbarimin e afatit.

**Kontrata do te zgjidhet para afatit ne keto raste:

- Ne rastin kur nuk do te paguhet qiraja per 2 muaj do te zgjidhet automatikisht .
- Me vullnetin e perbashket te te dy paleve.
- Kur sendit do ti shkaktohen deme nga ana e qiramarresit dhe mospagesa ndaj te treteve dhe qiradhenesi pervecse do te kerkoje zgjidhjen e kontrates do te kerkoje dhe demshperblim sipas dispozitave te K. Civil.
- Nese kontrata zgjidhet para afatit me vullnet te njeanshem te pales qiramarrese , pala qiramarrese vetem per arsye serioze te mosfunksionimit te firmes duhet te lajmeroje 2 muaj, para se te zgjidhet kontrata.

Me hyrjen ne fuqi te kesaj kontrate pra nga cdo kontrate tjeter e meparshme shfuqizohet automatikisht.

Cdo lloj mosmarveshje qe mund te linde ndermjet paleve duhet te zgjidhet sipas dispozitave te K.Civil mbi kontraten e qirase , nenet 801 -825 , dispozitave te cilat u referohet kjo kontrate.Nese nuk zgjidhen ne menyre vullnetare do t'i drejtohen Gjykates Kompetente per zgjidhjen e konfliktit.

Palet pasi e lexuan kontraten jane plotesisht dakort me permbajtjen e saj dhe ne keto kushte e firmosin e ate pa verejtje dhe me vullnet te pavesuar para meje noteres dhe une noterja e vertetoj ate sipas ligjit. U pagua dhe taksa 200 lek dhe tarifa +TVSH 4200 lek..

I bashkengjiten kesaj kontrate qiraje nje kopje e kopje te dokumentave e identifikimit dhe dokumenti i pronesise .

QIRADHENESI

Kristaq Karanxha

QIRAMARRESI

„Korsel „ SHPK

Perfaqesuar nga Maksim Fejzulla

NOTERE

Kleva Tabaku

Kristaq Karanxha

Maksim Fejzulla

Kleva Tabaku

SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

Vol 23, Fq 130

ona Kadastrale: 8564 NR. I PASURISE: 7/61

--> Vijon nga Vol, Fq

Indeksi i Hartes: KO-P-7

Vijon ne: Vol, Fq deri ne: Vol, Fq

Adresa e Pasurise: Rrethi KORÇE Q/F KORÇE

PERFUNDIMTARE (data):

Rr/L P/G SH K Ap

B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Eloji Pasurise: TRUALL Brenda V.K.N. : PO, Ref PL

RREGULL

Sip. Totale e Pasurise:	Nga Sip. Totale: sa Truall	Nga Sip. Truall: sa Nderestet
1. 1.493.00 m ² Ref 00003160	1. 1.493.00 m ² Ref 00003160	1. m ² Ref.
2. m ² Ref.	2. m ² Ref.	2. m ² Ref.
3. m ² Ref.	3. m ² Ref.	3. m ² Ref.
4. m ² Ref.	4. m ² Ref.	4. m ² Ref.

Per pjesen e perbashket:
PALLAT
Kuota e pjesmarrjes:
%
Nr i Pasurise (pallat):
Vol Faqe.

Pershkrim i veçante

C - SEKSIONI I PRONESISE

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr. Pasap	I/F/B	Adresa e Pronarit	Shuma e Paguar	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma
00007057	22/07/2005	Firma Karaxha Shpk				I		4,000,000		i shjte	

**D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PERDORIM, MARREVESHJEVE KUFIZUESE,
SERVITURAVE DHE INTERESAVE TE TJERA**

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
ZYRA QËNDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME KORÇË
 Adresa: Rruga 11 Nentori, Lagj. Brigada 17 S (pranë Prefekturës)

KORÇË, më 10 / 6 / 2019

SHËNIM: Kjo kopje kartele në A4, ka fuqi të njëjtë me origjinalin e ndodhur në zyrën tone

Në regjistrin Vol 23, Faqe 130, Zona Kadastrale 8564, Qyteti Korçë

[Handwritten signature]



HARTA TREGUESE REGJISTRIMIT
(Fragment)

DREJTORIA VENDORE E ASHK
KORÇË

DREJTOR
Nada BANDILLI

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

Z.KADASTRALE 8564 NR PASURIE 7/61 Vol 23 Fq 130

INDEKSI HARTES 60-P-7 SHKALLA 1:500

ADRESA E PASURISE: Rrethi KORÇE Q/F KORÇE

Rr/L _____ P/G _____ Sh _____ K _____ Ap _____

B. KUFIZIMET

V. 7/58

L. 7/223

J. 10/74

P. 10/74


D.Data: 10/16/18

C. PRONARET

FIRMA KESHXHI

SHPK

Ora [Signature]



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 146 Rep.
Nr. 305 Kol.

Taksa e Pulles u likujdua



KONTRATE QIRAJE

Sot ne Tirane me date 08 Tetor 2018 (Dymije e Tetembedhjete) ,para meje noteres Rajmonda Dyrmishi,anetare e Dhomes se Notereve Tirane, me seli ne rrugen "Myslym Shyri "P.72/1, shk.2, ap.25 u paraqiten personalisht per hartimin e nje kontrate qiraje ne baze te nenit 801 e vijuesa te Kodit Civil, palet si me poshte :

PALA QIRADHENESE:

GAZMOR BEKTESHI ,atesia Qamil ,i datelindjes 14.10.1958 , banues ne Tirane , Rr." Myslym Shyri",Pll.6,shk.4,ap.28 me zotesi te plate juridike per te vepruar , identifikuar me leternjoftimin ID Nr.024493487/F81114056K, leshuar dt 05.03.2009.

SHPRESA BEKTESHI, atesia Skender ,e datelindjes 17.04.1959, banuese ne Tirane, ne adresen e emesiperme,me zotesi te plate juridike per te vepruar , identifikuar me leternjoftimin ID Nr.024493483 /F95417111E,leshuar dt 05.03.2009.

PALA QIRAMARRESE:

Shoqeria "KORSEL" shpk me seli ne Korce , Objekt privat ,Bulevardi Fan. S. Noli, perballe Supermarket "Elisabet", me NIPT-in J64104124G, regjistruar ne Regjistrin Tragtar date 23/09/1996 e perfaqsuar nga adminsitratori i saj z.**MAKSIM FEJZULLA** , atesia Hysen, i datelindjes 20.02.1955, banues ne Korce, Lgj.18, Rruga" Jorgjia Truja" P.1,H.2, Ap.6 me zotesi te plate juridike per te vepruar,identifikuar me leternjoftimin Nr.025798978/ F50220316F, leshuar date 25.05.2009, i perfaqsuar me Prokure te Pergjithshme Nr.1177 Rep. Nr.236 Kol. date 25.02.2016(noter Manushaqe Jaupi) , nga z.Erald Fejzulla, atesia Maksim i datelindjes 08.04.1991, lindur e banues ne Korce, banues ne Korce, Lgj.18, Rruga" Jorgjia Truja" P.1,H.2, Ap.6 " me zotesi te plate juridike per te vepruar,identifikuar me leternjoftimin Nr032973360/J10408108R, leshuar dt 11.12.2015.

OBJEKTI I KONTRATES

Pasuria apartament i ndodhur ne rrugen e" Duresit ", Pll.144/1, shkalla.1, ap.30 ,me sipërfaqe 59.96 m2 (pesedhjete e nente pike nentedhjete e gjashte), fakt i cili vertetohet me Kontrate shitje me Kusht me Entin Kombetar te banesave Tirane dhe blerese Gazmor dhe Shpresa Bekteshi, Nr. 2202 Rep, Nr.675 kol,date 13.08.1999(hartuar nga noter Baroshe Hoxha),Tirane .

Objekti i kesaj kontrate eshte e gjithe pasuria - Apartament - me sipërfaqe prej 59.96 m2.

Pala Qiradhenese deshiron ta jape me qira ambjentin e mesiperm dhe qiramarresi deshiron ta marre ate me qira ,duke rene dakort me kushtet si vijon:

KOHEZGJATJA DHE RINOVIMI

Maredhenia e qirase eshte per nje (1) afat vjecar ,afat i cili sipas deklarimit te plave ka filluar me 01 Tetor 2018 dhe perfundon me 30 Shtator 2019. Qiramarresit i njihet e drejta e preferimit , per te njejtin afat kontraktor, ne raste perseritje te maredhenies se qirase mbi pasurinee lartepershkruar.

DESTINACIONI

Qiramarresi detyrohet te perdore ambjentin e marre me qira per nevoja te shoqerise .

CMIMI

Çmimi I qirase,me marreveshje te paleve eshte vendosur te jete ne **vleren 25.000 leke** (njezete e pesemije) ne muaj , Pagesa e qirase do te kryhet paradhenie cdo date 1-5 te muajit .Per cdo rast pagesa e qirase do te vertetohet me faturat perkatese.

Ne baze te Vendimit Nr.469,date 3.6.2015 " per caktimin e vleres miniale te cmimit te refarencave te qirave tendertesave per qellime tatimore", **pala qiramarrese eshte pergjegjes per pagimin e tatimit mbi qirane ne masen 5478 leke**(pesemije e katerqinde e shtatedhjete e tete) ne muaj te ndalura ne burim. Objekti kontrate qiraje ndodhet ne refencat e zones nr. 10/1, dhe origjina e saj vjen nga Privatizimi I banesave shteterore " Ligji Nr.7652,date 23.12.1992,dhe cmimi pasurise apartament ne kete zone eshte $145.00 \text{ lek/m}^2 \times 70\% \times 0.6\% = 609 \text{ lek/m}^2$.

Qiramarresi angazhohet qe,personalisht ose permes personave te ngarkuar prej tij, te paguaj ne menyre te permuajshme tatimin mbi qirane,duke u konsideruar vete pergjegjes per cdo mospagese.

SHPENZIMET

Jane ne ngarkim te qiramarresit shpenzimet e mbajtjes se zakonshme te pasurise se paluajtshme te objektit te qirase, ndersa shpenzimet e jashtezakonshme jane ne ngarkim te qiradhenesit.

Qiramarresi ka te drejten e investimit ne inventar te imet dhe paisje si dhe te heqjes se tyre me mbarimin e afatit kontraktor.Qiramarresi ka te drejten e heqjes se invetarit te imet dhe paisjeve si dhe sendeve qe per nga natyra e tyre mund te hiqen pa cenuar destinacionin ekonomik apo vleren ekonomike te objektit te qirase.

Cdo punim mirembajtje dhe riparimi behet me miratimin paraprak te qiradhenesit.





Qiramarrësi ka detyrimin e pagimit në mënyrë të përmuajshme të faturave të konsumit të energjisë elektrike, ujit të pishëm, duke bërë pagimin e faturave të shpenzimeve pranë entit furnizues përkatës.

NDALIMI I NENQIRASE

Eshtë e ndaluar për qiramarrësin të japë me nenqira krejtësisht apo pjesërisht ose të cetojë kontratën e qirase, përveçse me miratimin e shprehur me shkrim të qiradhenesit.
RUAJTJA

Qiramarrësi detyrohet të ruajë me kujdes sendin e dhënë me qira dhe ta dorëzojë në të njëjtën gjendje në të cilën e ka marrë në dorëzim, duke u konsideruar përgjegjës për çdo dëm të shkaktuar prej tij apo të tretëve.

INSPEKTIM DHE KONTROLLI

Qiradhenësi ka të drejtë të kryejë inspektime dhe kontrole mbi objektin e dhënë me qira të paktën çdo 2 muaj.

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E PALEVE

- DETYRIMET E QIRADHENESIT

Qiradhenësi merr përsipër dorëzimin e objektit tek qiramarrësi me proces-verbal të rregullt të nënshkruar nga palet.

Qiramarrësi është i detyruar të paise qiramarrësin me dokumentacionin e nevojshëm ligjor e teknik që vërteton titullin e pronësisë mbi pasurinë e dhënë me qira.

Qiradhenësi është i detyruar të sigurojë qiramarrësit përdorimin e qete, nga çdo pretendim pronësie nga të tretët, të mos kërkojë zgjidhjen e kësaj kontrate para afatit si dhe të respektojë kushtet e kësaj kontrate brenda afatit.

Qiradhenësi ka detyrimin që të paguajë të gjitha detyrimet ligjore ndaj organeve financiare shtetërore që rëndojnë mbi pasurinë e dhënë me qira.

- DETYRIMET E QIRAMARRRESIT

Qiramarrësi ka detyrimin të marrë objektin me proces-verbal dhe ta dorëzojë në përfundim të afatit kontraktor gjithashtu me proces verbal.

Qiramarrësi ka detyrimin të ruajë dhe mirmbajë objektin e marrë me qira.

Të kryej pagesat në afatin e caktuar.

Të zhdëmtojë dëmet e shkaktuara në objektin e qirase dhe ta dorëzojë objektin si në gjendjen fillestare.

GJYKATA KOMPETENTE

Palet do të bëjë gjithë përpjekjet për të zgjidhur mosmarrveshjet me mirëkuptim, dhe në rast se mirëkuptimi është i pamundur të arrihet, palet do të drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Të ndryshme. Për çfarë nuk është parashikuar shprehimisht në këtë kontratë dhe ka

nevoje per interpretim ne te ardhmen , palet do te referohen ne dispozitat e kodti civil mbi qirane Neni 801 e vijuesa.

Cdo njoftim qe palet do ti drejtojne njera-tjetres ne lidhje me kete kontrate do te konsiderohet i kryer nese kryhet me shkrim e dergohet nepermjet postes te regjistruar ne adresat e mesiperme.

Kjo kontrate qiraje hartohet sipas deshires se paleve ne kater kopje origjinale ne gjuhen shqipe duke patur te njejten fuqi ligjore.Kjo kontrate pasi u lexua nga palet,u kuptua dhe nuk kane verejtje nenshkruhet prej tyre rregullisht para meje noteres.

Une noteria vertetoj aktin sipas ligjit .

PALET

QIRADHENES

Gazmor Beushi

Mjeres Beushi
Shyqiri

NOTERE

Rajmondo Gjoni



QIRAMARRES

Shoqeria "KORSEL" shpk

E perfaqsuar me Prokure te posacme
nga Erald Fejzulla

